



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.77/16, gusht 2010) dhe bazuar në nenin 4, paragrafi 3, si dhe në zbatim të Kapitullit IV të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR QEVERISJEN KORPORATIVE TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të fuqizojë kornizën rregullative lidhur me praktikën e mira të qeverisjes korporative të siguruesve, si faktor i rëndësishëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sektorit të sigurimeve në Republikën e Kosovës. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për Aksionarët, Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë lidhur me përgjegjësitë e tyre në qeverisjen korporative të siguruesve.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit që veprojnë në Republikën e Kosovës, të licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).
3. Përveç nëse në mënyrë specifike kërkohet në ndonjë dispozitë të kësaj rregullore, kjo rregullore nuk aplikohet për degët e siguruesve të jashtëm të licencuar nga BQK-ja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim siç janë përkufizuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për Sigurimet) dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllime të kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Qeverisje korporative** - nënkupton mënyrën e qeverisjes së biznesit dhe aktiviteteve të siguruesit duke ndarë të drejtat dhe përgjegjësitë ndërmjet aksionarëve, Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Lartë, që ndikon në mënyrën e përcaktimit të hierarkisë, të strategjisë dhe objektivave të siguruesit, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e personelit, kryerjen e aktiviteteve ditore të siguruesit, përcaktimin dhe respektimin e kodit të sjelljes të siguruesit dhe sigurimin e operimit në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi si dhe mënyrën e përcaktimit të funksioneve të kontrollit.

Neni 3

Kërkesat e përgjithshme

1. Bordi i Drejtorëve të siguresit mban përgjegjësinë kryesore për qeverisjen korporative brenda institucionit sigures gjatë gjithë kohës si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha kërkesave ligjore dhe rregullative të siguresit.
2. Menaxhmenti i Lartë luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e qeverisjes efektive dhe është përgjegjës për sigurimin e funksionit të mbikëqyrjes efektive në përputhje me politikat e Bordit.
3. Të gjithë siguresit duhet të kenë një strukturë të qartë organizative me linja përgjegjësish të përcaktuara mirë, transparente dhe të qëndrueshme, procese efektive për identifikimin, menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e rreziqeve ndaj të cilave siguresi është i ekspozuar ose mund të ekspozohet. Siguresit duhet gjithashtu të sigurojnë procedurat e shëndosha administrative dhe të kontabilitetit, sistemet dhe kontrollet e TI-së, politikat dhe praktikatat e kompensimit që promovojnë menaxhimin e shëndoshë dhe efektiv të rrezikut, si në bazë individuale apo dhe në nivel grupi.
4. Sistemi i qeverisjes duhet të promovojë një kulturë të përshtatshme të rrezikut dhe pajtueshmërisë në të gjitha nivelet e institucionit dhe duhet t'i nënshtrohet rishikimit të brendshëm në baza të rregullta kohore.
5. Struktura e qeverisjes e vendosur nga secili sigures duhet të jetë e përshtatshme për të siguruar mbikëqyrjen efektive të aktiviteteve të siguresit duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit.
6. Struktura dhe politikat e qeverisjes korporative duhet të artikuloohen në mënyrë të qartë dhe të jenë në dispozicion për të gjithë stafin e siguresit.
7. Siguresi duhet të krijojë, implementojë dhe mirëmbajë një plan të vazhdimësisë së biznesit me qëllim që të sigurojë, në rast të ndonjë ndërprerje të sistemit të tyre, ruajtjen e informatave thelbësore si dhe të sigurojë vazhdimësinë e aktiviteteve të sigurimit dhe risigurimit apo kur kjo nuk është e mundur të parashih rikuperimin në kohë të të dhënave të ruajtura me qëllim të rifillimit të aktiviteteve të siguresit.

Neni 4

Pronësia e siguresve

1. Qeverisja e mirë korporative kërkon që aksionarët kryesorë të siguresve që veprojnë në Kosovë të plotësojnë kriterin “të përshtatshëm dhe të duhur” ashtu siç përcaktohet në nenin 24 të Ligjit për Sigurime. BQK-ja do të vlerësojë dhe sigurojë se të gjithë pronarët kryesorë të siguresve përmbushin këtë kërkesë.
2. Sipas nenit 24 dhe 35 të Ligjit për Sigurimet, të gjithë aksionarët kryesorë të siguresit duhet të kenë miratimin paraprak të BQK-së në mënyrë që të sigurohet që aksionarët t'i plotësojnë kriteret e të qenit “të përshtatshëm dhe të duhur”.
3. Për çdo ndryshim të strukturës së aksioneve që përbëjnë më pak se 10% të aksioneve të siguresit, siguresi duhet ta njoftojë BQK-në me shkrim brenda 5 ditëve të punës nga data e ndryshimeve të tilla, të cilat duhet të reflektohen në Statutin e siguresit. Sipas nenit 23 të Ligjit për Sigurimet, çdo ndryshim i Statutit dhe aktit themeltar të siguresit duhet t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga BQK-ja.

4. Përgjegjësitë dhe aspektet tjera të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të siguruesve janë të përcaktuara në nenin 26 të Ligjit për Sigurimet.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve të siguruesve

1. Bordi i Drejtorëve të siguruesve duhet të veprojë në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit për Sigurimet.
2. Secili nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve të siguruesve duhet:
 - 2.1 të veprojë në mirëbesim, ndershmëri dhe arsyeshmëri;
 - 2.2 të ushtrojë detyrat e tyre me kujdesin dhe përkushtimin e duhur;
 - 2.3 të veprojë në interesin më të mirë të siguruesve dhe policëmbajtësve, duke i vendosur këto interesa para interesave personale të tyre;
 - 2.4 të ushtrojë gjykim të pavarur dhe objektiv, në vendimmarrje duke marrë parasysh interesat e siguruesve dhe policëmbajtësve;
 - 2.5 të mos e shfrytëzojnë pozitën e tyre për ndonjë përfitim personal dhe të mos i shkaktojnë dëme siguruesit.
3. Detyrat specifike individuale të përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të përfshihen si pjesë të kushteve të angazhimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve nga siguruesit.
4. Anëtari individual i Bordit të Drejtorëve të një siguruesi që ushtron aktivitete në klasët e sigurimit jo-jetë, nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i Bordit ose Menaxher i Lartë i një siguruesi tjetër që ushtron aktivitete në klasët e sigurimit jo-jetë.
5. Anëtari individual i Bordit të Drejtorëve të një siguruesi që ushtron aktivitete në klasët e sigurimit jetë, nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i Bordit ose Menaxher i Lartë i një siguruesi tjetër që ushtron aktivitete në klasët e sigurimit jetë.
6. Kur një anëtar individual i Bordit të Drejtorëve të një siguruesi është anëtar i Bordit të Drejtorëve ose Menaxher i Lartë, (me përjashtim të situatave nga paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni), në një entitet tjetër, Bordi i Drejtorëve duhet të ketë procedura qartë të definuara në lidhje me obligimin për besnikëri ndaj siguruesit. Këto procedura duhet të përfshijnë shpalosjen adekuate nga anëtari i Bordit të Drejtorëve si dhe mund të përfshijnë miratimin nga aksionarët për këtë situatë të angazhimit paralel në dy entitete. Nëse një situatë e tillë mund të shpie në konflikt të interesit me interesat e siguruesit, anëtari i Bordit të Drejtorëve duhet ta shpalos këtë konflikt te Bordi i Drejtorëve, si dhe duhet të mos merr pjesë në votimin për çështjet për të cilat ai ka interes.

Neni 6

Kualifikimet e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve

1. Të gjithë anëtarët e Bordit duhet të kenë përvojë, kompetenca dhe cilësi personale adekuate. Kriteret për kualifikimin si “i përshtatshëm dhe i duhur” janë të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit për Sigurimet, ndërsa kriteret për kualifikimin dhe përvojën janë të përcaktuara në 32 të Ligjit për Sigurimet dhe në Rregulloren për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm.

2. Bordi si grup duhet të sigurojë që spektri i plotë i njohurive dhe përvojës që nevojiten për të mbikëqyrur institucionin është brenda Bordit si tërësi. Kjo nënkupton që anëtarët e Bordit preferohet të kenë edukim të fushave të ndryshme dhe përvoja të ndryshme.
3. Asambleja e Aksionarëve duhet të vlerësojë standardin e shkathtësive dhe përvojës që ka Bordi në radhët e anëtarëve të tij në raport me strukturën që do të ishte ideale për siguruesin. Zbrazëtitrat e konsiderueshme të identifikuara duhet të përdoren si bazë e rëndësishme për emërimet e ardhshme të Bordit.
4. Anëtarët e Bordit duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 24 dhe 32 të Ligjit për Sigurimet dhe duhet të miratohen paraprakisht nga BQK-ja në pajtim me nenet 24 dhe 33 të Ligjit për Sigurimet. BQK-ja do të marrë parasysht çështjet e përcaktuara në Ligjin për Sigurimet, rregulloret në zbatim të tij, përfshirë këtë rregullore, si dhe legjislacionin në fuqi për të vendosur nëse do ta miratojë një emërim apo jo.
5. Paragrafi 4 i këtij neni zbatohet për degën e siguruesit të jashtëm vetëm në lidhje me menaxherët e lartë.

Neni 7

Struktura e Bordit të Drejtorëve

1. Neni 27 i Ligjit për Sigurimet ka përcaktuar kërkesat minimale për strukturën e Bordit. Këto kërkesa minimale janë:
 - 1.1. Bordi përbëhet nga një numër tek prej jo më pak se pesë (5) anëtarësh;
 - 1.2. të gjithë anëtarët e Bordit kanë të drejtë vote;
 - 1.3. të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve me të drejtë vote, duhet të jenë drejtor joekzekutiv;
 - 1.4. së paku njëri prej anëtarëve të Bordit duhet të jetë rezident në Republikën e Kosovës;
 - 1.5. Kryeshefi Ekzekutiv shërben në Bord sipas detyrës zyrtare dhe pa të drejtë vote.
2. Anëtarët e Bordit emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.
3. Përbërja e Bordit duhet të jetë adekuate që të mund të përballohen rastet kur një anëtar ose disa anëtarë duhet të largohen nga vendimmarrja për shkak të konfliktit potencial të interesit.
4. Bordi, së paku në baza vjetore, duhet të kryejë një vetë-vlerësim dhe të rishikojë përbërjen e tij, si dhe të përcaktohet për përbërjen më efektive lidhur me marrjen e vendimeve dhe përcaktimin e strategjisë.
5. Bordi duhet të mbajë shënimet e duhura të diskutimeve dhe vendimeve. Këto, sipas kërkesës, duhet të vihen në dispozicion të BQK-së.

Neni 8

Komitetet e Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i drejtorëve duhet të themelojë Komitetin e Auditimit, Komitetin për Menaxhimin e Rrezikut dhe Komitetin për Menaxhim të Investimeve.

2. Siguruesi mund të themelojë edhe komitete tjera sipas vlerësimit të tij. BQK-ja në kuadër të kompetencave të saj, mund të kërkojë nga siguruesi të themelojë komitete të posaçme.
3. Nenet 8, 9, 10,11 dhe 12 të kësaj Rregulloreje nuk aplikohen për degët e siguruesve të jashtëm, për aq sa kërkesat e krahasueshme dhe të pranueshme për BQK-në zbatohen me legjislacionin, sipas të cilit siguruesi i jashtëm është licencuar në shtetin amë.

Neni 9

Përgjegjësitë e Komiteteve të Bordit të Drejtorëve

1. Autoriteti, funksionet, anëtarësia dhe linjat raportuese të Komiteteve si dhe frekuenca e takimeve, të drejtat e votës dhe kuorumet duhet të jenë të specifikuara qartë me shkrim në statut ose udhëzim të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve.
2. Termat e referencës duhet të rishikohen rregullisht nga Komitetet për të siguruar përshtatshmërinë e vazhdueshme. Rekomandimet për rishikim duhet t'i ofrohen Bordit të Drejtorëve, atëherë kur është e nevojshme. Këto rishikime duhet të dokumentohen dhe duhet të bëhen të paktën një herë në vit.
3. Siguruesi duhet t'i përmbahet kërkesave në vijim lidhur me komitetet e Bordit të Drejtorëve:
 - 3.1. rendi i ditës dhe i gjithë materiali relevant për takimin do t'u shpërndahen të gjithë anëtarëve të komitetit në kohën e duhur para takimit;
 - 3.2. procesverbalet e detajuara të të gjitha takimeve të komiteteve duhet të përgatiten dhe të përmbajnë regjistrimin e kohës së takimit, vendndodhjen e mbajtjes së takimit, të pranishmit, të gjitha diskutimet kryesore dhe vendimet e marra;
 - 3.3. kur emëron anëtarët e komitetit, Bordi i Drejtorëve duhet të shqyrtojë dhe të bindet për ekspertizën përkatëse, aftësinë e anëtarëve dhe mundësinë e tyre për të ndarë kohë të mjaftueshme për komitetin;
 - 3.4. anëtarët e komitetit duhet rregullisht të marrin pjesë në takimet e komitetit. Kur një anëtar e ka të pamundur që për një kohë të gjatë të marrë pjesë në takimet e komitetit, Bordi i Drejtorëve duhet të zëvendësojë atë anëtar me një anëtar tjetër, i cili duhet të ketë përvojën dhe ekspertizën relevante;
 - 3.5. anëtarët e Komiteteve duhet të marrin pjesë në çdo takim të komitetit, mirëpo në rastet kur për shkak të vendndodhjes të disa anëtarëve pjesëmarrja fizike nuk është e mundshme, lejohet pjesëmarrja përmes videokonferencës apo telekonferencës;
 - 3.6. të qenit anëtar në disa komitete njëkohësisht, i një individ të caktuar, duhet të menaxhohet nga siguruesi ashtu që siguruesi të sigurohet që asnjë individ të mos ushtrojë ndikim apo kontroll të tepërt;
 - 3.7. anëtarët e komiteteve duhet të rishikohen nga Bordi i Drejtorëve të siguruesit dhe duhet të jenë subjekt i ripërtëritjes me një frekuencë kohore të përshtatshme;
 - 3.8. komitetet duhet të raportojnë rregullisht te Bordi i Drejtorëve si dhe procesverbalet e çdo takimi duhet t'i dërgohen Bordit të Drejtorëve para mbajtjes së takimeve të Bordit të Drejtorëve.

Neni 10

Komiteti i auditimit

1. Komiteti i Auditimit duhet të themelohet nga Bordi i Drejtorëve.
2. Numri i anëtarëve të Komitetit të Auditimit duhet të jetë i mjaftueshëm duke marrë parasysh madhësinë, natyrën dhe kompleksitetin e të bërit biznes dhe nuk mund të ketë më pak se tre (3) anëtarë.
3. Komiteti i Auditimit duhet të jetë i përbërë prej anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, shumica nga të cilët duhet të jenë anëtarë joekzekutiv si dhe një anëtar duhet të jetë ekspert i jashtëm me përvojë së paku tre (3) vjeçare në fushën e financave, kontabilitetit dhe auditimit.
4. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë eksperti i jashtëm i angazhuar si anëtar i Komitetit të Auditimit.
5. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve nuk duhet të jetë anëtar i Komitetit të Auditimit. Pjesëmarrja e Drejtorit Ekzekutiv apo Kryesuesit të Bordit në takimet e Komitetit të Auditimit duhet të organizohet vetëm përmes ftesës dhe duhet të menaxhohet në mënyrë që nuk e cenon pavarësinë e këtij Komiteti dhe mbajtjes së relacioneve të duhura me palët tjera dhe veçanërisht me auditorët e jashtëm.
6. Takimet e Komitetit të Auditimit duhet të mbahen në intervale të rregullta kohore, në minimum çdo tre muaj në vit të mbahet nga një (1) mbledhje e zakonshme, ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme do të mbahen sa herë të thirren nga Bordi i Drejtorëve ose nga vet komiteti i siguruesit. Vendimet e Komitetit të Auditimit janë valide kur janë të pranishëm dhe votojnë shumica e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Pjesëmarrësit e këtyre mbledhjeve kryesisht duhet të jenë Kryesuesi i Komitetit dhe anëtarët e tij. Megjithatë, anëtarët mund të kërkojnë pjesëmarrjen e personave tjerë kyçë, siç janë auditori i jashtëm, drejtori i auditimit të brendshëm dhe drejtori i financave apo edhe personat tjerë sipas kërkesës së komitetit. Komiteti i Auditimit duhet të veprojë në përputhje me sigurimin e pavarësisë së tij dhe duhet t'i raportojë aktivitetet dhe vendimet e tij te Bordi i Drejtorëve.
7. Pa paragjykuar përgjegjësinë e Bordit të Drejtorëve, përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit përveç atyre të përcaktuara në nenin 30, paragrafit 4, të Ligjit për Sigurimet, përfshijnë të paktën edhe përgjegjësitë e shënuara më poshtë:
 - 7.1. monitorimi i efikasitetit dhe përshtatshmërisë së kontrollit të brendshëm të siguruesit, auditimit të brendshëm dhe sistemeve të TI;
 - 7.2. bashkëpunimi me auditorin e jashtëm veçanërisht në raport me gjetjet e tyre të auditimit;
 - 7.3. rishikimi i besueshmërisë së pasqyrave financiare të siguruesit dhe sigurimi që ato paraqesin gjendjen financiare të saktë dhe të drejtë të siguruesit;
 - 7.4. rishikimi i çdo njoftimi apo raportimi financiar dhe rekomandimi para se t'i përcillet Bordit të Drejtorëve për miratimin apo jo të pasqyrave financiare vjetore të siguruesit;
 - 7.5. vlerësimi i pavarësisë së auditorit të jashtëm.

Neni 11

Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut

1. Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për themelimin e Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut të ndarë nga Komiteti i Auditimit. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut, përveç përgjegjësive të përcaktuara në nenin 30, paragrafi 7, të Ligjit për Sigurimet ka përgjegjësi të mbikëqyrë dhe të këshillojë Bordin e Drejtorëve për ekspozimin aktual të siguruesit ndaj rreziqeve si dhe për strategjinë e menaxhimit të rrezikut për të ardhmen.
2. Numri i anëtarëve të këtij komiteti duhet të jetë i mjaftueshëm duke marrë parasysh natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e të bërit biznes dhe nuk mund të ketë më pak se tre (3) anëtarë. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut duhet të përbëhet vetëm nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve.
3. Kryesuesi i Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut nuk mund të jetë njëkohësisht edhe kryesues i Bordit të Drejtorëve.
4. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut si tërësi duhet të ketë ekspertizë relevante për menaxhimin e rrezikut.
5. Roli i Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut duhet të jetë këshillimi i Bordit të Drejtorëve për apetitin dhe tolerancën e rrezikut për strategjinë e së ardhmes, të marrë parasysh apetitin e përgjithshëm të rrezikut të marrë nga Bordi i Drejtorëve, pozicionin aktual financiar të siguruesit duke u mbështetur në punën e Komitetit të Auditimit apo të auditorit të jashtëm.
6. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut duhet vazhdimisht të bashkëpunojë me Udhëheqësin e Funkcionit të Rrezikut në mënyrë që të sigurojë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit për menaxhim të rrezikut të siguruesit duke marrë parasysh madhësinë, natyrën dhe kompleksitetin e rreziqeve të vetvetishme të të bërit biznes.
7. Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut duhet vazhdimisht të këshillojë Bordin e Drejtorëve për efikasitetin e strategjisë dhe politikave me qëllim që të sigurojë mbulueshmëri adekuate të rreziqeve.

Neni 12

Komitetet tjera të Bordit të Drejtorëve

Siguruesi duhet të themelojë Komitetin për Menaxhim të Investimeve në pajtim me nenin 30, paragrafi 8, të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Investimin e Aseteve në Mbulim të Provizioneve Teknike dhe Matematike si dhe Investimin e Kapitalit Themeltar të Siguruesve.

Neni 13

Emërimi dhe mbikëqyrja e menaxhmentit të lartë të siguruesve

1. Bordi i Drejtorëve i siguruesit që vepron në Kosovë duhet ta përzgjedhë dhe emërojë Menaxhmentin e Lartë të siguruesit dhe nëse është e nevojshme ta zëvendësojë atë. Në rastin e degëve të siguruesve të jashtëm, kjo i takon Bordit të Drejtorëve të siguruesit amë.
2. Me qëllim të përmbushjes së këtij roli, Bordi duhet:

- 2.1. të përcaktojë standardet e kërkesave lidhur me kriteret ” të përshtatshëm dhe të duhur” për përzgjedhjen e të gjithë menaxherëve, jo vetëm të atyre Menaxherëve të Lartë për të cilët nevojitet miratimi i BQK-së;
- 2.2. të monitorojë veprimet e Menaxherëve të Lartë dhe të sigurojë që ato janë në përputhje me strategjitë e miratuara dhe kufijtë e rrezikut të siguresit;
- 2.3. të përcaktojë standarde formale të performancës për Menaxherët e Lartë. Ata duhet të sigurojnë që këto standarde të performancës janë në përputhje me interesat afatgjata të siguresit dhe të mos çojnë pa dashje në marrje të tepërt të rrezikut në aspektin afatshkurtër;
- 2.4. të sigurojë që njohuritë dhe ekspertiza e Menaxherëve të Lartë mbeten në nivelin e duhur në rast të ndryshimeve në natyrën e biznesit, profilin e rrezikut ose mjedisin operativ të siguresit;
- 2.5. të ketë planin e përshtatshëm të vazhdimësisë për të siguruar që humbja e Menaxherëve kyçë nuk do të ndikojë negativisht në performancën e siguresit.

Neni 14

Kualifikimet e Menaxherëve të Lartë

1. Të gjithë Menaxherët e Lartë të siguresve të licencuar për operim në Kosovë duhet t’i plotësojnë kriteret për “ të përshtatshëm dhe të duhur” sipas përcaktimeve të nenit 24 të Ligjit për Sigurimet si dhe të kenë kualifikimet, përvojën dhe integritetin e duhur, sikurse kërkohet me nenin 32 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Siguresve dhe Degëve të Siguresve të Jashtëm.
2. Ky nen aplikohet edhe për degët e siguresve të jashtëm të licencuar në Kosovë.

Neni 15

Konfliktet e interesit

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë të siguresit duhet të trajtojnë konfliktet e interesit dhe transaksionet me palët e ndërlidhura në pajtim me dispozitat e nenit 34 të Ligjit për Sigurimet, të cilat për siguresit e jashtëm aplikohen vetëm për Menaxherët e Lartë të tij.

Neni 16

Përgjegjësitë e Menaxhmentit të Lartë

1. Menaxhmenti i Lartë është përgjegjës për operacionet e përditshme të siguresit.
2. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë se veprimtaritë e siguresit kryhen në çdo kohë në mënyrë konsistente me strategjinë e biznesit, strategjinë dhe kufizimet e rrezikut dhe politikat dhe kufizimet e tjera të specifikuara nga Bordi.
3. Anëtarët e Menaxhmentit të Lartë duhet të kenë përvojën, kompetencat dhe integritetin e duhur për të menaxhuar biznesin dhe personelin nën mbikëqyrjen e tyre. Ata duhet të kenë qasje në trajnime të rregullta për të mbajtur dhe avancuar njohuritë e tyre, si dhe për të qenë të përditësuar me zhvillimet e fundit që janë përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.
4. Organizimi, procedurat si dhe vendimmarrja e Menaxhmentit të Lartë duhet të jenë të qarta, transparente dhe të dizajnuara për të promovuar menaxhimin efektiv të siguresit. Kjo përfshin

qartësinë mbi rolin, autoritetin dhe përgjegjësinë e pozitive të ndryshme brenda Menaxhmentit të Lartë.

5. Menaxhmenti i Lartë është në veçanti përgjegjës për:
 - 5.1. të ndihmuar Bordin në krijimin dhe ruajtjen e kulturës dhe kodit të mirësjelljes;
 - 5.2. ligjshmërinë e operacioneve të siguruesit;
 - 5.3. implementimin e strategjisë së vendosur afariste të siguruesit; sistemet për menaxhimin e rrezikut, kulturën e rrezikut, proceset dhe kontrollet për menaxhimin e rrezikut;
 - 5.4. ofrimin e mbikëqyrjes së duhur për ata të cilët i menaxhojnë;
 - 5.5. vendosjen e sistemeve informative të menaxhmentit që do të sigurojnë se informatat e duhura, me kohë dhe të sakta do të vihen në dispozicion të Bordit, BQK-së si dhe palëve të tjera të interesit;
 - 5.6. këshillimin e Bordit për strukturën e duhur organizative të siguruesit;
 - 5.7. sigurimin se numri dhe cilësia e personelit dhe burimet e tjera janë adekuate për kryerjen e të gjitha detyrave të siguruesit;
 - 5.8. komunikimin e drejtimit strategjik, tolerancës së rrezikut dhe linjave raportuese brenda siguruesit dhe përshkrimin dhe dokumentimin e qartë të përgjegjësiave për secilin anëtar të personelit.
6. Ky nen aplikohet edhe për degët e siguruesve të jashtëm të licencuar në Kosovë.

Neni 17

Politika e Kompensimit

1. Bordi i Drejtorëve të siguruesit duhet të miratojë politikën e kompensimit për siguruesin që përfshin kompensimet për Menaxhmentin e Lartë, punonjësit dhe shkallën e përqindjes së kompensimit për ndërmjetësuesit e sigurimeve.
2. Politika e kompensimit nuk duhet të shkaktojë marrjen e rrezikut të papërshtatshëm, dhe duhet të jetë në pajtim me objektivat, profilin e rrezikut, strategjitë dhe interesat afatgjata të siguruesit si dhe duhet të përfshijë masat që parandalojnë konfliktin e interesit.
3. Bordi duhet të monitorojë rregullisht funksionimin e sistemeve të kompensimit të siguruesit për të siguruar që ato janë duke u zbatuar si duhet dhe nuk inkurajojnë marrjen e rrezikut të papërshtatshëm nga siguruesi.
4. Kompensimi duhet të jetë simetrik me rrezikun e siguruesit për të siguruar përputhjen e interesave të anëtarit të personelit me ato të siguruesit.
5. Në rastet kur politika e kompensimit parasheh kompensimin në mënyre fikse dhe variabile, siguruesi duhet të sigurojë që pjesëmarrja e pagesës fikse të jetë në lartësinë e duhur të kompensimit në tërësi, në mënyrë që të parandalojë varësinë ndaj pagesës variabile si dhe të përmbajë mundësinë e anulimit të pagesës variabile në rastet e performancës jo të mirë.
6. BQK-ja rezervon të drejtën që të vlerësojë dhe nëse është e nevojshme, të kërkojë ndryshime për sistemet e kompensimit të siguruesit, nëse vlerëson se sistemi ekzistues i kompensimit mund të

inkurajojë marrjen e rrezikut të papërshtatshëm nga siguruesit dhe /ose mund të ketë ndikime negative në gjendjen financiare të siguruesit.

7. Performanca e Bordit, në zbatimin e këtij neni, do të jetë një element i rëndësishëm i vlerësimit të performancës së përgjithshme të Bordit në kuadër të ekzaminimit të siguruesit nga BQK.
8. Për kompensimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve vendos Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Neni 18

Funksioni i pajtueshmërisë

1. Bordi i Drejtorëve të siguruesit është përgjegjës për të siguruar se siguruesi është në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse.
2. Bordi i Drejtorëve duhet të themelojë funksionin e pajtueshmërisë brenda strukturës organizative të siguruesit.
3. Funksioni i Pajtueshmërisë duhet t'i ndihmojë Bordin e Drejtorëve në mënyrë që siguruesi:
 - 3.1 t'i përmbushë obligimet ligjore, rregullative dhe mbikëqyrëse;
 - 3.2 të promovojë dhe mbështet kulturën e pajtueshmërisë;
 - 3.3 të monitorojë pajtueshmërinë me politikën e brendshme të siguruesit.
4. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se funksioni i pajtueshmërisë ka autorizimet e nevojshme për të kryer funksionin e tij dhe se është i pajtur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për identifikimin efikas të rrezikut të pajtueshmërisë.
5. Bordi i Drejtorëve do të miratojë procedurat e nevojshme për zbatimin adekuat dhe efikas të politikës së funksionit të pajtueshmërisë.
6. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë krijimin e mekanizmit për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet funksionit të pajtueshmërisë dhe funksioneve tjera të siguruesit.
7. Udhëheqësi i funksionit të pajtueshmërisë, duhet të informojë Menaxhmentin e Lartë dhe duhet të raportojë te Bordi i Drejtorëve, i cili gjithashtu do të vendosë për kompensimin e tij.
8. Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e udhëheqësit të funksionit të pajtueshmërisë.
9. Në rast të shkarkimit ose dorëheqjes të udhëheqësit të pajtueshmërisë, arsyet e shkarkimit ose dorëheqjes duhet t'i komunikohen BQK-së brenda shtatë ditëve të punës.
10. Udhëheqësi i funksionit të pajtueshmërisë, konsiderohet Menaxher i Lartë dhe duhet të miratohet paraprakisht nga BQK-ja.
11. Udhëheqësi i funksionit të pajtueshmërisë duhet t'i plotësojë kriteret për miratim të Menaxherëve të Lartë të përcaktuara me Ligjin për Sigurimet dhe aktet nënligjore të BQK-së.
12. Përveç siç përcaktohet më lart në këtë nen, funksioni i pajtueshmërisë, do të kryejë edhe detyrat e mëposhtme në lidhje me identifikimin dhe monitorimin e rrezikut të pajtueshmërisë:
 - 12.1. përcjelljen dhe respektimin e rregulloreve që kanë të bëjnë me veprimtaritë e siguruesit;

- 12.2. identifikimin dhe monitorimin e rrezikut të mos-pajtueshmërisë së operacioneve të siguruesit me rregulloret;
 - 12.3. monitorimin dhe testimin e pajtueshmërisë dhe informimin tek Menaxhmenti i Lartë dhe raportimin te Bordi i Drejtorëve për mos-pajtueshmërinë e përcaktuar dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra për tejkalimin e tyre;
 - 12.4. këshillimin e vazhdueshëm dhe efikas të anëtarëve të Menaxhmentit të Lartë dhe Bordit të Drejtorëve në zbatimin e rregulloreve;
 - 12.5. informimin e Menaxhmentit të Lartë dhe raportimin direkt te Bordi i Drejtorëve ose një Komiteti të Bordit të Drejtorëve të caktuar për pajtueshmëri në pajtim me politikën e funksionit të pajtueshmërisë;
 - 12.6. vlerësimin e ndikimit të mundshëm të rregulloreve dhe ndryshimeve të reja në operacionet e siguruesit dhe mjedisin ku siguroesi vepron;
 - 12.7. vlerësimin e harmonizimit të produkteve të reja dhe proceseve afariste të siguruesit në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
 - 12.8. sigurimin e trajnimeve dhe informimit të punonjësve për mënyrat e zbatimit të ligjeve përkatëse dhe akteve nënligjore në operimin e tyre të përditshëm;
 - 12.9. bashkëpunimin me institucionet rregullative;
 - 12.10. dokumentimin e operacioneve të tij dhe paraqitjen e raporteve të rregullta informuese te Menaxhmenti i Lartë i siguruesit dhe raportimin drejtpërdrejt te Bordi i Drejtorëve, në përputhje me politikën e funksionit të pajtueshmërisë.
13. Fushëveprimi dhe veprimtaritë e funksionit të pajtueshmërinë duhet t'i nënshtrohen rishikimit periodik nga funksioni i auditimit të brendshëm.
 14. Ky nen është i zbatueshëm edhe për degët e siguruesve të jashtëm të licencuar në Kosovë.

Neni 19

Funksioni për menaxhimin e rrezikut

1. Çdo siguroes duhet të krijojë një funksion efektiv për menaxhimin të rrezikut që është i aftë të ndihmojë siguroesin në:
 - 1.1. identifikimin, vlerësimin, monitorimin, zvogëlimin dhe raportimin në kohë të duhur për rreziqet kryesore; dhe
 - 1.2. promovimin dhe ruajtjen e një kulture të shëndoshë të menaxhimit të rrezikut.
2. Funksioni për menaxhimin e rrezikut duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët posedojnë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme, duke përfshirë njohuritë e tregut dhe produkteve që ofron siguroesi si dhe zotërimin e njohurive në fushat e rrezikut. Funksioni për menaxhimin e rrezikut duhet të udhëhiqet nga Udhëheqësi i funksionit për menaxhimin e rrezikut.
3. Udhëheqësi i funksionit për menaxhimin e rrezikut, duhet ta informojë apo t'i raportojw Menaxhmentit të Lartë si dhe duhet të ketë mundësinë për të raportuar drejtpërdrejt te Bordi i Drejtorëve dhe/ose tek Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut. Bordi i Drejtorëve do të vendosë për kompensimin e tij.

4. Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e udhëheqësit të funksionit për menaxhimin e rrezikut.
5. Në rast të shkarkimit ose dorëheqjes të udhëheqësit të funksionit për menaxhimin e rrezikut, arsyet e shkarkimit ose dorëheqjes duhet t'i komunikohen BQK-së brenda shtatë ditëve të punës.
6. Udhëheqësi i funksionit për menaxhimin e rrezikut, duhet t'i plotësoj kriteret e Ligjit për Sigurimet dhe akteve nënligjore të BQK-së për Menaxherët e Lartë të siguruesve dhe duhet të miratohet paraprakisht nga BQK-ja.
7. Funksioni për menaxhimin e rrezikut duhet të ketë qasje dhe të raportojë drejtpërdrejt te Bordi, ashtu siç kërkohet nga Bordi, së paku për çështjet si:
 - 7.1. vlerësimin e rreziqeve dhe ekspozimit të siguruesit ndaj këtyre rreziqeve si dhe hapat të cilat janë ndërmarrë për menaxhimin e këtyre rreziqeve;
 - 7.2. vlerësimin e ndryshimit të profilit të rrezikut të siguruesit në raport me apetitin e rrezikut të siguruesit;
 - 7.3. kur është e përshtatshme, vlerësimin e limiteve të përcaktuara paraprakisht;
 - 7.4. kur është e përshtatshme, çështjet e menaxhimit të rrezikut që rezultojnë nga strategjia e biznesit, bashkimet dhe blerjet si dhe projektet madhore apo investimet;
 - 7.5. vlerësimin e ngjarjeve të rrezikut dhe identifikimin e veprimeve të përshtatshme të korrigjimit.
8. Funksioni për menaxhimin e rrezikut duhet të ketë autoritetin dhe obligimin të informojë me kohë Bordin dhe/ apo Komitetin për Menaxhimin e Rrezikut për çdo rrethanë që mund të ketë efekt material në sistemin e menaxhimit të rrezikut të siguruesit.
9. Aktivitetet kyçe të funksionit për menaxhimin e rrezikut duhet të përfshijnë:
 - 9.1. të ndihmojë Bordin dhe Menaxhmentin e Lartë në kryerjen e përgjegjësisë të tyre përkatëse, përfshirë ofrimin e analizave profesionale dhe kryerjen e rishikimit të rreziqeve;
 - 9.2. identifikimin e rreziqeve materiale individuale dhe të agreguara (aktuale, të shfaqura dhe të mundshme) të siguruesit;
 - 9.3. vlerësimin, agregimin, monitorimin dhe ofrimin e ndihmës në menaxhimin dhe adresimin e rreziqeve të identifikuara (kjo përfshinë kapacitetin e siguruesit për të absorbuar rrezikun duke marrë parasysh natyrën, probabilitetin, kohëzgjatjen, korelacionin dhe ashpërsinë potenciale të rrezikut);
 - 9.4. të krijojë dhe të mirëmbajë një pasqyrë të profilit të agreguar të rrezikut të siguruesit si një person juridik dhe nëse është e aplikueshme edhe në nivel grupi;
 - 9.5. të krijojë vlerësim largpamës të profilit të rrezikut;
 - 9.6. të vlerësojë mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm në vazhdimësi në mënyrë që të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e mundshme sa më herët që është e mundur;
 - 9.7. të konsiderojë rreziqet që rrjedhin nga marrëveshjet e kompensimit si dhe nga skema e bonuseve;
 - 9.8. të kryejë stres-teste të rregullta;
 - 9.9. informimin për Menaxhmentin e Lartë dhe raportimin në baza të rregullta kohore për Bordin ose Komitetin e Rrezikut, lidhur me profilin e rrezikut të siguruesit dhe detajet e rreziqeve ndaj të cilave siguruesi është i ekspozuar si dhe propozimi i metodave të përshtatshme për zvogëlimin e këtyre rreziqeve;

- 9.10. të dokumentojë dhe t'i raportojë Bordit për ndryshimet materiale që ndikojnë në sistemin e siguruesit për menaxhimin e rrezikut në mënyrë që ky sistem vazhdimisht të mirëmbahet dhe përmirësohet; dhe
 - 9.11. të kryejë vetëvlerësime të rregullta dhe të zbatojë apo monitorojë implementimin e çdo përmirësimi të nevojshëm.
10. Ky nen është i zbatueshëm edhe për degët e siguruesve të jashtëm të licencuar në Kosovë.

Neni 20

Degët e siguruesve të jashtëm që operojnë në Kosovë

1. Kur një sigures licencohet nga BQK-ja për operim në Kosovë si degë e siguruesit të jashtëm, zbatohen këto kërkesa:
 - 1.1. degës nuk do t'i kërkohet të themelojë Bord në Kosovë;
 - 1.2. emërimet e Menaxhmentit të Lartë të degës kërkojnë miratimin paraprak të BQK-së;
 - 1.3. Menaxhmenti i Lartë pritet të sigurojë se politikat dhe rregullat e grupit janë përshtatur me mjedisin në Kosovë;
 - 1.4. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me legjislacionin dhe rregullativën tjetër në fuqi në Kosovë. Çfarëdo konflikti ndërmjet kërkesave të legjislacionit të Kosovës dhe kërkesave të legjislacionit të vendit amë duhet të raportohet në BQK.
 - 1.5. dega duhet t'i ofrojë BQK-së informata të tilla në lidhje me operacionet e veta dhe të institucionit amë të saj sipas kërkesave nga BQK-ja, në mënyrë që BQK-ja të jetë e informuar me operacionet e degës që i nënshtrohen mbikëqyrjes adekuate nga siguruesit dhe mbikëqyrësit e vendit të origjinës.
2. Përveç siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për Sigurimet, nëse BQK-ja vjen në përfundim se operacionet e degës vlerësohen si operacione të rëndësishme sistemike për sistemin financiar në Kosovë, për shkak të madhësisë së tyre apo ndonjë tipari tjetër, BQK-ja ka të drejtë t'i kërkojë siguruesit të jashtëm që degën në Kosovë ta shndërrojë në subjekt të varur.

Neni 21

Trajtimi i çështjeve shqetësuese

1. Çdo sigures duhet të krijojë një proces të qartë me shkrim, përmes të cilit punonjësit mund t'i komunikojnë Menaxhmentit të Lartë apo Bordit të Drejtorëve çfarëdo shqetësimi legjitim që kanë në lidhje me praktikën dhe veprimtarinë e paligjshme, jo-etike dhe të dyshimta në rastet kur çështja përfshin një anëtar të Menaxhmentit të Lartë të siguruesit. Procesi duhet të jetë i atillë që t'i krijojë punonjësit besimin dhe konfidencialitetin që mund të komunikojë çështje të tilla në mbrojtje të plotë nga çfarëdo forme të ndëshkimit.
2. Pa paragjykuar ndonjë detyrim tjetër ligjor, çdo drejtor që ka ndonjë shqetësim material për qeverisjen e përgjithshme të një siguresi duhet së pari të raportojë pa vonesë te Bordi i Drejtorëve. Nëse shqetësimi i tij/saj nuk është adresuar në mënyrë të kënaqshme nga Bordi i Drejtorëve brenda pesë ditëve të punës, drejtori menjëherë do të raportojë shqetësimin e tij në Bankën Qendrore, duke dhënë arsyen e shqetësimit dhe çdo propozim për korrigjim të situatës. Kjo nuk e përjashton

mundësinë e drejtorit për të raportuar direkt në Bankën Qendrore shqetësimet e tilla edhe pa i raportuar ato te Bordi i Drejtorëve.

Neni 22

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Sigurimet.

Neni 23

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulli 24 mbi Qeverisjen e Përbashkët të Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës